

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË VENDIM

Kërkesa nr. 50249/13

KIÇO GURMA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 28 nëntor 2023 si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,

Duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 50249/13) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 2 gusht 2013, nga një shtetas shqiptar, z. Kiço Gurma (“kërkuesi”), i lindur në vitin 1931, me banim në Sarandë dhe përfaqësuar nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) - përfaqësuar nga Agjenti i saj i asaj periudhe, znj. E. Muçaj, dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit - për ankesat në lidhje me parimin e sigurisë juridike, kohëzgjatjen e procesit dhe një zgjidhje efektive për këtë aspekt dhe të drejtën e kërkuesit për të gëzuar në paqe pasurinë e tij, si dhe vendimin për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë kryesisht me aspektet e drejtësisë dhe kohëzgjatjes së procesit civil dhe të drejtat mbi pronën.

2. Në vitin 1994, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave Sarandë (“Komisioni”) njohu të drejtat e kërkuesit dhe të familjarëve të tij mbi pronësinë e trashëguar ndaj një trualli me sipërfaqe 50,000 metra katrorë (trualli i parë), dhe në vitin 2003, një trualli tjetër me sipërfaqe 6,205 metra katrorë (trualli i dytë).

3. Më 2 maj 1996, A. C. bleu një truall me sipërfaqe 910 metra katrorë nga Bashkia e Sarandës. Në realitet, ajo sipërfaqe toke i përkiste truallit të dytë të përshkruar më sipër. Kjo marrëveshje ishte regjistruar rregullisht në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme Sarandë (“RPP”).

4. Më 12 nëntor 2002, kërkuesi dhe të afërmit e tij ngritën një padi civile në Gjykatën e Rrethit Sarandë ndaj Bashkisë së Sarandës, me anë të së cilës i kërkonin kësaj gjykate të përcaktonte kufijtë e saktë të truallit të parë, dhe të plotësonin vendimin e kthimit duke iu dhënë një truall shtesë.

5. Në vendimin e datës 27 janar 2003, Gjykata e Rrethit Sarandë përcaktonte kufijtë e saktë të truallit të parë, dhe pasi vlerësoi, me anë të një raporti të përgatitur nga ekspertë, se trualli i dytë nuk ishte i zënë, ia riktheu këtë truall paditësve.

6. Më 21 janar 2004, kërkuesi nisi një proces civil ndaj A. C., duke i kërkuar që t'i jepte pronësinë e truallit për të cilin po debatohej, dhe më 19 janar 2006, ai ngriti një padi tjetër ndaj A. C. duke kundërshtuar pronësinë e saj të truallit me sipërfaqe 910 metra katrorë, me argumentin se ky truall i ishte kthyer atij me anë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Sarandë në vitin 2003. Këto procese u bashkuan në vitin 2006.

7. Në vitin 2006, A. C. nisi një proces civil paralel kundër kërkuesit, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit, sipas suplementit në vendimin e Gjykatës së Rrethit Sarandë të vitit 2003. Pas delegimit nga Gjykata e Lartë për Gjykatën e Apelit, të dy proceset u bashkuan në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila, me anë të një vendimi të datës 25 tetor 2010, rrëzoi padinë e kërkuesit dhe pranoi kundërpadinë e A. C. Gjykata vendosi se vendimi i Komisionit, sipas suplementit të vendimit të

Gjykatës së Rrethit Sarandë, ishte i pavlefshëm për sa kishte të bënte me truallin e A. C. me sipërfaqe 910 metër katrorë.

Gjykata e Apelit gjykoi se vendimi i Komisionit mbështetej në dokumente të paplota dhe të pasakta. Nuk kishte prova se prona konkrete ishte shtetëzuar, shpronësuar apo nënshtruar ndonjë forme tjetër përvetësimi nga Shteti pas datës 29 nëntor 1944. Në një shënim të vitit 1943 në lidhje me këtë pronë përcaktohej se paraardhësi i kërkuarit kishte përfutur vetëm një pjesë me sipërfaqe 25,056 metër katrorë nga trualli me sipërfaqe 50,000 metër katrorë në total. Trashëgimtarët nuk mund të kishin trashëguar më shumë tokës nga sa kishte trashëguar paraardhësi i tyre.

Në vijim, Gjykata e Apelit konstatoi se trualli i kërkuarit me sipërfaqe 6,205 metër katrorë (trualli i dytë) mbivendosej me truallin prej 910 metër katrorë të A. C. Gjykata e Apelit gjykoi se, duke qenë se kthimi në natyrë i 6,205 metrave katrorë për paditësin kishte qenë i paligjshëm pasi vendimi për kthimin mbështetej në dokumente jo të plota dhe të pasakta, nuk kishte arsye që të kërkohej pronësia e atij trualli.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit gjykoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit Sarandë i datës 27 janar 2003 nuk kishte efekt mbi A. C., pasi ajo nuk kishte qenë palë në atë proces. Ajo gjykoi se provat e paraqitura provonin pronësinë e A. C. ndaj truallit konkret.

8. Kërkuari depozitoi një ankesë pranë Gjykatës së Lartë me argumentin se pronësia e tij ndaj truallit konkret ishte njohur me anë të vendimit të Komisionit dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Sarandë. Kontakti për shitje midis A. C. dhe Bashkisë Sarandë duhej të ishte anuluar pasi blerësja nuk kishte përmbushur kriteret ligjore sipas parashikimit në ligjin për planifikimin urban. Gjithashtu, Bashkia Sarandë do ta kishte pasur të pamundur t'i shiste A. C. truallin konkret, sepse transferimi i pronës publike nuk ishte i lejueshëm në atë periudhë, deri në përfundim të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.

9. Më 11 korrik 2012, Gjykata e Lartë rrëzoi *de plano* ankesën e kërkuarit në Gjykatën e Lartë.

10. Në vijim, kërkuari depozitoi një ankesë kushtetuese, që u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese më 10 dhjetor 2012.

VLERËSIMI I GJYKATËS

NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS DHE NENI 1 I PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

1. *Parimi i sigurisë juridike*

11. Kërkuari u ankua se vendimet e gjykatave vendase nuk kishin respektuar parimin e sigurisë juridike dhe *res judicata* kur ndryshuan vendimet e Komisionit dhe të Gjykatës së Rrethit Sarandë, që kishin njohur pronësinë e tij ndaj truallit konkret, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe gëzim paqësor të pasurive të tij, të garantuara me anë të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1.

12. Gjykata thekson se për pronësinë e truallit konkret u vendos në procesin civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjrokastër, tërësisht në mënyrë të shkelur nga procesi në të cilin u miratua vendimi i datës 27 janar 2003, dhe midis palëve të ndryshme.

13. Fakti se A. C. nuk ishte palë në grupin e parë të këtyre procedimeve, është i një rëndësie parësore, dhe, për këtë arsye, ajo kishte të drejtën të kundërshtonte pronësinë e kërkuarit ndaj pronës konkrete, dhe të kërkonte pronësinë ndaj atij trualli, pavarësisht vendimit të Gjykatës së Rrethit Sarandë. Gjykata thekson se në të gjitha sistemet juridike efektet *res judicata* të vendimeve kanë kufizime *ad personam*, si edhe sipas fushëveprimit material (shih *Esertas kundër Lituanisë*, nr. 50208/06, § 22, 31 maj 2012). Në të vërtetë, rezulton se tashmë në vitin 1996, përpara se kërkuari të niste procesin ndaj Bashkisë së Sarandës, A. C. kishte marrë titullin e pronësisë për pronën konkrete, dhe se pas asaj date, Bashkia e Sarandës nuk ishte pronari i truallit konkret. Megjithatë, kërkuari bëri një padi civile ndaj Bashkisë së Sarandës, dhe jo ndaj A. C., edhe pse marrëveshja midis A. C. dhe Bashkisë së Sarandës ishte regjistruar në RPP (shih paragrafin 3 më sipër).

14. Për këtë arsye, i vetmi mjet për A. C. për të mbrojtur të drejtën e saj të pretenduar ndaj truallit konkret ishte procesi civil ndaj kërkuarit. Gjykata e Apelit Gjrokastër nuk e rishqyrtoi një çështje për të cilën tashmë ishte vendosur në procesin ku përfshiheshin palët e njëjta, por një mosmarrëveshje ku përfshiheshin palë të ndryshme. Për këtë arsye, ajo nuk kundërshtonte aspektin *ad personam* të parimit të respektimit të efektit *res judicata* të vendimeve (krahaso *Podrugina dhe Yedinov kundër Rusisë* (vendim), nr. 39654/07, 17 shkurt 2009; *Tantilovi kundër Bullgarisë* (vendim), nr.

39351/05, § 36, 13 janar 2015; dhe *Gurițanu kundër Moldavisë* (vendim) [Komiteti], nr. 75732/12, § 12, 8 nëntor 2022).

15. Për këtë arsye, kjo ankesë duhet të deklarohet e papranueshme pasi është e pambështetur qartazi në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a), dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 4 të Konventës.

2. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë

16. Gjykata vëren se apelimi i kërkuarit në Gjykatën e Lartë kundërshtonte vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata vlerëson se arsyet e kufizuara dhënë nga Gjykata e Lartë në formulën e saj të papranueshmërisë tregonin në mënyrë të nënkuptuar se kërkuari nuk kishte adresuar një nga pikat e së drejtës, parashikuar në nenin 472 të KPC-së. Gjykata vëren se në rastin kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se ajo nuk kishte shkaqet juridike të apelit, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, § 106, GJEDNJ 2007 (ekstrakte)). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata thekson se Gjykata e Apelit ka dhënë arsye të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për vendimin e saj.

17. Në këtë mënyrë, duke shqyrtuar procedurat në tërësi, Gjykata konstaton se është respektuar e drejta e kërkuarit për shqyrtimin e duhur të çështjes së tij nga gjykatat vendase dhe detyrimin e tyre për të dhënë arsyet e duhura për vendimin e tyre.

18. Për këtë arsye, kjo ankesë duhet të deklarohet e papranueshme pasi është e pambështetur qartazi në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a), dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 4 të Konventës.

3. Kohëzgjatja e procedimeve dhe një zgjidhje për këtë aspekt

19. Parimet e përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve janë përmbledhur në *Frydlander kundër Francës* ([DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

20. Procedurat për të cilat janë drejtuar ankesat nisën më 21 janar 2004 dhe u përmbyllën me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 10 dhjetor 2012, pasi zgjatën tetë vjet, dhjetë muaj dhe nëntëmbëdhjetë ditë përpara katër niveleve të juridiksionit. Për shkak të një delegimi, vendimet u dhanë në gjashtë shkallë (krahaso *Seliga kundër Sllovenisë* (vendim), nr. 33578/02, 30 nëntor 2006).

21. Sipas Gjykatës, çështja është komplekse pasi ajo përfshinte paditë e kërkuarit, një kundërpadi të palës kundërshtuese, dhe kishte të bënte me çështje komplekse të kthimit të pronës dhe mbivendosjes së titujve ndaj pronës.

22. Gjykata konstaton se sjelljes së kërkuarit nuk mund t'i atribuohet asnjë vonesë.

23. Për sa ka të bëjë me reagimin e gjykatave vendase, Gjykata vëren se asnjë prej shkallëve të gjyqimit nuk iu nevojiti më shumë se tre vjet për të dhënë vendimin e tyre. Në lidhje me këtë të fundit dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës (shih, për shembull, *L. Z. kundër Sllovakisë* (vendim), nr. 27753/06, 27 shtator 2011, dhe *Lyszczyńska kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 34863/04, 4 janar 2008), Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e përgjithshme prej tetë vitesh, dhjetë muajsh dhe nëntëmbëdhjetë ditëve pranë katër niveleve të juridiksionit, dhe në gjashtë shkallë, nuk tejkaloi atë që mund të konsiderohet afat i arsyeshëm për rrethanat (krahaso *Ekholm kundër Finlandës* (vendim), nr. 5952/03, 10 korrik 2007 dhe *Steiner kundër Austrisë* (vendim), nr. 32637/96, 22 nëntor 2001).

24. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 4 të Konventës.

25. Për sa ka të bëjë me kërkesën sipas nenit 13, Gjykata vëren se ajo lidhet në mënyrë të pandashme me ankesën e shqyrtuar më sipër dhe për këtë arsye duhet të shpallet e papranueshme (shih *Ljubičić kundër Kroacisë* (vendim), nr. 17338/05, 10 maj 2007).

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 11 janar 2024.

ZËVENDËSSEKRETARE
Olga Chernishova

KRYETAR
Georgios A. Serghides